

**VENDIM**  
**Nr. 20, datë 24.2.2026**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji kryetare;

Marsida anëtare;

Xhaferllari

Sonila Bejtja anëtare;

Sandër Beci anëtar;

Ilir Toska anëtar;

Genti Ibrahimimi anëtar;

Marjana Semini anëtare;

Asim Vokshi anëtar,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 24.2.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 10 (Sh) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Shadije Lika

SUBJEKT I INTERESUAR:

Prokuroria E Përgjithshme, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 158, datë 6.2.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2024-312, datë 27.2.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rigjykim me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: Nenet 30, 32, paragrafi 2, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarës Shadije Lika (*kërkuesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Dibër (*DRSSH-ja, Dibër*) ka paraqitur kallëzim penal ndaj kërkuarës, për shkak se nga një hetim i auditimit të brendshëm ka rezultuar se ajo ka

përfitur në mënyrë të padrejtë pension pleqërie duke përdorur dokumente të falsifikuara. Sipas procesverbalit të auditimit të datës 15.5.2015 ka rezultuar se kërkuesja ka përfitur pension pleqërie me vendimin e datës 20.5.1997 të DRSSH-së, Dibër, si nënë me shumë fëmijë, me periudhë sigurimi 24 vjet e 1 muaj, me efekte financiare nga data 1.3.1997 dhe masë pensioni 3.250 lekë. Gjatë procesit të auditimit është konstatuar mospërputhje e periudhave të sigurimit, pasi ka rezultuar se përfitimi i kërkueses ishte lidhur sipas pasqyrit të librezës së punës të lëshuar nga Ndërmarrja e Furnizimit të Punëtorëve, Krastë (*NFP-ja, Krastë*), ku pasqyrohej periudha e punës 6.1.1965–31.12.1988. Ndërkohë, nga verifikimi i bazës të të dhënave të digjitalizuara, ka rezultuar se emri i kërkueses figuronte i regjistruar në ish-kooperativën Laç, Bruç, me periudhë sigurimi 1967-1990, e provuar kjo me vërtetimin nr. 781 prot, datë 14.5.2015 të DRSSH-së, Dibër. Po nga ky verifikim i bazës të të dhënave të digjitalizuara kërkuesja nuk figuronte e regjistruar në regjistrat e NFP-së, Krastë. Prokuroria ka arritur në konkluzionin se kërkuesja ka përfitur pension pa plotësuar kriteret ligjore sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, sipas të cilit duhet të kishte plotësuar 19 vjet periudhë sigurimi ose vjetërsinë prej 15 vjetësh për të përfitur pension të pjesshëm pleqërie. Në përfundim të hetimeve, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Dibër ka dërguar në gjyq çështjen në ngarkim të kërkueses, duke e akuzuar atë për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi në sigurime”, të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal (KP).

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr. 55, datë 7.3.2018, ka vendosur pushimin e çështjes penale me nr. 278/15 akti, datë 20.11.2017, në ngarkim të kërkueses, për shkak se ndjekja penale për veprën penale “Mashtrimi në sigurime” nuk duhet të fillonte. Kjo gjykatë ka arsyetuar se kërkuesja nuk e ka konsumuar veprën penale nga ana objektive. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 158, datë 6.2.2019, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe deklarinin fajtores të kërkueses për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi në sigurime” dhe dënimin e saj me 100.000 lekë gjobë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesja.

4. Me vendimin nr. 00-2024-312, datë 27.2.2024, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesja, për shkak se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

5. Në datën 15.4.2025 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Kolegji i Gjykatës në datën 18.6.2025 ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila në datën 24.6.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

## II

### Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

6. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet objekt kundërshtimi i kanë cenuar:

6.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

6.1.1. *Parimit të gjykatës së caktuar me ligj*, pasi ndonëse kërkuesja ka paraqitur dokumentet zyrtare të lëshuara nga qendra e punës, si dhe dëshmitarët, gjykatat nuk i kanë marrë ato parasysht

dhe nuk i kanë vlerësuar si prova në favor të saj. Ato nuk janë dokumente private të krijuara nga kërkuesja, por akte zyrtare të lëshuara nga nëpunës shteti të autorizuar nga ligji dhe brenda kompetencës së tyre dhe si të tilla përbëjnë provë të plotë. Në asnjë shkallë të gjyimit nuk është provuar se aktet janë të falsifikuara.

6.1.2. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi gjykatat nuk kanë analizuar provat e paraqitura nga kërkuesja, vlerën e tyre në raport me vlerën e provave të prokurorisë. Në këtë mënyrë është shkelur edhe *e drejta e mbrojtjes*.

6.1.3. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk i kanë arsyetuar me hollësi pretendimet e kërkueses dhe faktin se përse nuk kanë marrë parasysh aktet zyrtare dhe shkencore, por kanë keqinterpretuar faktet dhe ligjin. Vendimi i Gjykatës së Lartë është skematik, pa argumente, jologjik e jologjor dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të paraqitura në rekurs nga kërkuesja.

6.1.4. *Parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme*, pasi kërkuesja ka përfutur pension pleqërie në mënyrë të rregullt nga viti 2007 e në vazhdim dhe pas 10 vjetësh ai është ndërprerë me pretendimin se dokumentet e saj zyrtare janë cilësuar si të pavërteta.

6.2. *Parimin e prezumimit të pafajësisë*, pasi kërkuesja është dënuar mbi prova kontradiktore dhe të pavërtetuara përtej dyshimit të arsyeshëm. Të dyja provat e administruara janë të kundërta me njëra-tjetrën dhe gjykatat nuk i kanë sqaruar dhe verifikuar ato sipas ligjit. Kërkuesja ka paraqitur librezën e punës dhe vërtetimin e qendrës së punës si dokumente zyrtare të cilat përbëjnë provë të plotë dhe nuk janë shpallur të falsifikuara. Po kështu, pretendimet e saj janë mbështetur edhe nga dy dëshmitarë. Nga ana tjetër, prokuroria ka paraqitur si provë vërtetimin e lëshuar nga DRSSH-ja, Dibër, i cili është konsideruar i rregullt nga gjykatat, ndonëse nuk përmban gjeneralitetet e kërkueses. Gjykatat nuk kanë bërë asnjë hetim shtesë ose akt ekspertimi që të vërtetojë se këto akte të paraqitura nga kërkuesja nuk janë të vërteta, por të falsifikuara, por kanë bërë një vlerësim ndryshe të tyre.

6.3. *Parimin e zbatimit të ligjit penal favorizues*, të parashikuar nga neni 29, paragrafi 3, i Kushtetutës, për shkak të mosaplikimit të ligjit nr. 22/2014, “Për dhënie amnistie” (*Ligji për dhënie amnistie*). Argumenti i Gjykatës së Lartë se kërkuesja nuk ka qenë subjekt i këtij ligji është i pabazuar, pasi fakti që çështja ishte pushuar në gjykatën e shkallës së parë nuk e përjashtonte atë, sepse vendimi nuk kishte marrë formë të prerë. Ky qëndrim është mbajtur edhe nga këshilltari ligjor në Gjykatën e Lartë, i cili i ka sugjeruar kolegjit pranimin e rekursit.

**7. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim me argumentin e pamundësisë objektive, për shkak se Gjykata nuk i ka vënë në dispozicion dosjen gjyqësore mbi bazën e së cilës është deklaruar fajtore kërkuesja.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

##### *A. Për legjitimitimin e kërkueses*

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor

që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

9. Kërkuesja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

10. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese, përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

11. Për legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i Ligjit Organik të Gjykatës ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Gjykata është shprehur se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare (*shih vendimin nr. 42, datë 19.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka pohuar se i takon, në radhë të parë, Gjykatës së Lartë të sigurojë që në dosjen e çështjes së saj të ketë prova për datën e dorëzimit të vendimit palëve (*shih Ibrahim dhe të tjerë k. Shqipërisë, datë 14.1.2025, § 13*).

12. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është i datës 27.2.2024, i cili është publikuar në faqen e kësaj gjykate në datën 4.4.2024. Kërkesa është paraqitur në datën 15.4.2025, ndërsa kërkuesja ka parashtruar se është njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë në datën 13.12.2024 në mënyrë rastësore, pasi asaj nuk i është komunikuar asnjëherë një kopje e vendimit dhe përfaqësuesi ligjor i ngarkuar me rekursin nuk e ka ndjekur çështjen. Për më tepër, kërkuesja ka pretenduar se është 78 vjeç, me arsim 4-vjeçar, nuk ka adresë *e-mail* dhe nuk di të përdorë kompjuterin ose internetin për të ndjekur fatin e çështjes së saj.

13. Për sa më lart, duke mbajtur në konsideratë jurisprudencën e GJEDNJ-së për detyrimin e Gjykatës së Lartë për njoftimin e vendimeve të saj dhe faktin se barra e provës në këtë drejtim nuk mund të rëndojë mbi kërkuesen, Gjykata çmon se ajo legjitimohet *ratione temporis*.

14. Po kështu, Gjykata konstaton se pas njoftimit të palëve për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, kërkuesja, në parashtrimet shtesë të datës 24.7.2025, ka pretenduar, gjithashtu, edhe cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme, me argumentin se ka përfituar pension pleqërie në mënyrë të rregullt nga viti 2007 e në vazhdim dhe pas 10 vjetësh ai është ndërprerë, pasi dokumentet e saj zyrtare janë cilësuar si të pavërteta.

15. Gjykata vëren se referuar nenit 1, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës dhe nenit 185 të KPC-së, shkaqet e ankimit kushtetues individual mund të ndryshohen (shtohen ose pakësohen) deri në momentin që vendoset kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Bazuar në këto parashikime, Gjykata çmon se ky pretendim i ri, i cili përbën shtesë të shkaqeve të ankimit

kushtetues individual, nuk mund të merret në shqyrtim, pasi ai është paraqitur nga kërkuesja pas vendimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

16. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesja ka pretenduar se vendimet gjyqësore i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit dhe standardit të arsyetimit të vendimit, si dhe parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin e zbatimit të ligjit penal favorizues.

17. Për sa i përket *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, kërkuesja ka pretenduar se gjykatat nuk kanë analizuar provat e paraqitura nga kërkuesja, vlerën e tyre në raport me vlerën e provave të prokurorisë, duke i cenuar edhe të drejtën e mbrojtjes. Gjithashtu, në lidhje me *parimin e gjykatës së caktuar me ligj*, kërkuesja ka pretenduar se gjykatat nuk i kanë marrë parasysh provat e paraqitura prej saj dhe nuk i kanë vlerësuar në favor të saj. Sipas saj, në asnjë shkallë të gjykimit nuk është provuar se aktet janë të falsifikuara. Nisur nga thelbi i parashtrimeve të kërkueses, Gjykata çmon t'i analizojë ato në drejtim të parimit të prezumimit të pafajësisë.

18. Lidhur me pretendimin për cenimin e *parimit të zbatimit të ligjit penal favorizues*, Gjykata vëren se kërkuesja ka pretenduar se gjykatat nuk kanë aplikuar Ligjin për dhënie amnistie dhe se argumenti i Gjykatës së Lartë se kërkuesja nuk ka qenë subjekt i këtij ligji është i pabazuar, pasi fakti që çështja ishte pushuar në gjykatën e shkallës së parë nuk e përjashtonte atë, sepse vendimi nuk kishte marrë formë të prerë. Ky qëndrim është mbajtur edhe nga këshilltari ligjor në Gjykatën e Lartë, i cili i ka sugjeruar kolegjit pranimin e rekursit.

19. Për sa i përket veprimtarisë së këshilltarit ligjor në Gjykatën e Lartë, nisur nga fakti se në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se veprimtaria që ushtron ai ka karakter këshillues dhe ndihmës, në ndryshim nga ajo e gjyqtarit, e cila ka karakter vendimmarrës dhe se kontrolli kushtetues ushtrohet vetëm ndaj vendimeve gjyqësore (*shih vendimet nr. 49, datë 5.10.2023; nr. 42, datë 19.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*), ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

20. Gjykata ka theksuar se parimi kushtetues i fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues duhet respektuar nga të gjitha gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, mjafton që fati i çështjes të mos jetë vendosur ende përfundimisht prej tyre. Për më tepër, ky parim duhet të respektohet edhe në gjykimin që mund të zhvillohet në Gjykatën e Lartë, sepse është pikërisht kjo Gjykatë që kontrollon mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 1, datë 20.1.2014; nr. 35, datë 20.12.2005; nr. 14, datë 17.4.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjykata vëren se Ligji për dhënie amnistie në nenin 3 ka parashikuar, ndër të tjera, se plotësojnë kriteret për të përfituar amnisti: a) personat e dënuar me burgim deri në 3 vjet, personat e dënuar me kusht, me gjobë apo personat, për të cilët gjykata ka caktuar një nga llojet e alternativave të dënimit me burgim, për dënime të dhëna deri në datën 31 dhjetor 2013, pavarësisht nga koha e mbetur nga dënimi, me përjashtim të personave të dënuar për veprat penale, të parashikuara në nenin 6 të këtij ligji; b) personat e dënuar, gra, që, në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë baras ose mbi moshën 50 vjeç, me përjashtim të personave të dënuar për veprat penale, të parashikuara në nenin 6 të këtij ligji.

22. Gjithashtu, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë ka vlerësuar se ky pretendim është i pabazuar, pasi procedimi penal është regjistruar në datën 19.7.2017 në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibër dhe çështja ka qenë në gjykim për veprimet e kryera nga kërkuesja, konkretisht

përfitimi në mënyrë të paligjshme i pensionit, edhe pas daljes së amnistisë. Sipas kësaj gjykate, kërkesja është dënuar me gjobë sipas vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë në datën 6.2.2019, ndërsa në shkallë të parë çështja ndaj saj ka qenë e pushuar. Në përfundim, ajo gjykatë ka vlerësuar se kërkesja nuk ka qenë subjekt i Ligjit për dhënie amnistie dhe pretendimi i saj nuk është i drejtë.

23. Bazuar në sa më lart, Gjykata eidenton se kallëzimi penal ndaj kërkeses është paraqitur në datën 13.1.2016, hetimet ndaj saj kanë përfunduar në datën 16.10.2017, kur është dërguar për gjykim procedimi penal dhe me vendimin e datës 7.3.2018 të gjykatës së shkallës së parë është vendosur pushimi i çështjes penale. Ndërsa me vendimin e datës 6.2.2019 gjykata e apelit ka vendosur shpalljen fajtores të kërkeses. Gjykata vëren se kërkesja i referohet ligjit për amnistinë të miratuar në vitin 2014, ndërkohë që procedimi dhe dënimi i saj rezultojnë respektivisht në vitet 2017 dhe 2019. Për më tepër, edhe Gjykata e Lartë i ka kthyer përgjigje këtij pretendimi, duke arritur në përfundimin se kërkesja nuk ka qenë subjekt i Ligjit për amnistinë. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkeses në këtë drejtim është haptazi i pabazuar, duke mos arritur ajo të provojë cenimin e së drejtës për të përfituar nga ligji penal favorizues.

24. Për sa i takon pretendimeve për cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë* dhe *standardit të arsytimit të vendimit*, Gjykata vëren se ato bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të analizohen në vijim në themel të ndërlidhura së bashku.

#### *B. Për themelin e pretendimeve*

*B.1. Për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*

25. Kërkesja ka pretenduar se është dënuar mbi prova kontradiktore dhe të pavërtetuara përtej dyshimit të arsyeshëm, pasi të dyja provat e administruara janë të kundërta me njëra-tjetrën dhe gjykatat nuk i kanë sqaruar dhe verifikuar ato sipas ligjit. Sipas saj, dokumentet e paraqitura në gjykim, librezat e punës dhe vërtetimi i qendrës së punës, janë dokumente zyrtare të cilat përbëjnë provë të plotë dhe nuk janë shpallur të falsifikuara. Nga ana tjetër, sipas kërkeses, prokuroria ka paraqitur si provë vërtetimin e lëshuar nga DRSSH-ja, Dibër, i cili është konsideruar i rregullt nga gjykatat, ndonëse nuk përmban gjeneralitetet e saj. Po kështu, kërkesja ka pretenduar edhe se gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk kanë arsyetuar me hollësi pretendimet e saj, nuk kanë marrë parasysh aktet zyrtare dhe shkencore, por kanë keqinterpretuar faktet dhe ligjin.

26. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ky parim kushtetues ka gjetur pasqyrim edhe në nenin 4 të KPP-së, i cili përcakton, gjithashtu, se çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit. Në jurisprudencën kushtetuese parimi i prezumimit të pafajësisë është elaboruar në drejtim të faktit se gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Gjykatat duhet të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 10, datë 12.4.2022; nr. 68, datë 14.11.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë të të pandehurit të

bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim. Sipas këtij parimi, asnjë dënim ose masë që barazohet me të nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 8, datë 20.2.2024; nr. 12, datë 24.8.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Për sa i përket së drejtës për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, Gjykata ka theksuar se, si pjesë e së drejtës për proces të rregullt ligjor, ajo garantohet nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Sipas Gjykatës, arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 21, datë 26.9.2022; nr. 67, datë 10.11.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*shih vendimet nr. 8, datë 20.2.2024; nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 63, datë 23.9.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Bazuar në standardet kushtetuese të sipërcituara, Gjykata do të verifikojë nëse në procesin penal të zhvilluar ndaj kërkueses gjykatat e zakonshme kanë respektuar garancitë procedurale të parimit të prezumimit të pafajësisë dhe nëse ato u kanë dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të saj në këndvështrim të standardit të arsyetimit të vendimit.

29. Në rastin konkret Gjykata vëren se kërkuesja është akuzuar për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi në sigurime”, të parashikuar nga neni 145 i KP-së, bazuar në kallëzimin penal të DRSSH-së, Dibër, e cila ka pretenduar se kërkuesja nëpërmjet përdorimit të dokumenteve të falsifikuara ka përfituar pension në mënyrë të padrejtë.

30. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka vendosur pushimin e çështjes penale, për shkak se ndjekja penale për këtë vepër nuk duhet të fillonte, me arsyetimin se kërkuesja nuk e ka konsumuar veprën penale nga ana objektive. Sipas kësaj gjykate, kërkuesja ka paraqitur kërkesë për të përfituar pension pleqërie pranë DRSSH-së, Dibër, duke depozituar librezën e punës të lëshuar nga NFP-ja, Krastë në datën 21.12.1988, nga ku, ndër të tjera, pasqyrohet periudha e punës 6.1.1965–31.12.1988. Ndërkohë, nga vërtetimi nr. 781 prot, datë 14.5.2015, i lëshuar nga DRSSH-ja, Dibër, rezulton se: “Në bazë të dokumenteve që disponon arkivi i ISSH-së vërtetohet, se: Shadije z. Lika Hoxha, lindur më \_ . \_ . \_ në \_\_, ka punuar në Rajonin Dibër, kooperativa bujqësore Laç, Bruç, sipas shënimeve të regjistrit nr. 03, fleta 118, nga viti 1967–1990.”. Në analizë të dokumenteve të paraqitura në gjykim, kjo gjykatë ka arritur në përfundimin se nuk provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesja ka konsumuar nga ana objektive figurën e veprës penale për të cilën akuzohet, pasi, *së pari*, vërtetimi nr. 781 prot, datë 14.5.2015, lëshuar nga DRSSH-ja, Dibër, nuk provohet se i përket së pandehurës, pasi në të nuk është pasqyruar identiteti i saktë i personit të cilit i përket. *Së dyti*, fakti se kërkuesja ka punuar pranë NFP-së, Krastë vërtetohet nga librezja e punës e lëshuar prej saj në datën 21.12.1988, nga vërtetimi i datës 10.3.1997 i lëshuar nga Ndërmarrja Likuidatori i NFP-së, Krastë, ndërsa nga shkresa e DRSSH-së, Dibër rezulton se nuk është administruar dokumentacioni i plotë i NFP-së, Krastë dhe as listë pagesa. Për më tepër, dy dëshmitarë në gjykim kanë dëshmuar se kërkuesja ka punuar pranë NFP-së, Krastë nga viti 1984 deri në 1995.

31. Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe deklarin fajtor të kërkueses për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi në sigurime” dhe dënimin e saj me 100.000 lekë gjobë, me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë nuk ka çmuar

provat në kuptim të nenit 152 të KPP-së. Më konkretisht, vërtetimi i DRSSH-së, Dibër nr. 781 prot, datë 14.5.2015 nuk është analizuar drejt, pasi ai provon se kërkuesja ka qenë punonjëse e ish-kooperativës Laç, Bruç dhe nuk mund të ishte njëkohësisht e punësuar dhe në një ndërmarrje tjetër. Po kështu, nga aktet shkresore është provuar se NFP-ja, Krastë ka regjistra të punëtorëve dhe emri i kërkueses nuk figuron në këta regjistra. Edhe dy dëshmitarët nuk japin të dhëna bindëse dhe pohimi i tyre nuk lidhet me asnjë provë tjetër të marrë në këtë gjykim.

32. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se vendimi i gjykatës së apelit është marrë në zbatim dhe interpretim të drejtë të ligjit penal material dhe procedural penal. Ai e ka gjetur të pabazuar pretendimin e kërkueses për zbatim të gabuar të ligjit penal në drejtim të ekzistencës së faktit penal të atribtuar dhe cilësimit të tij juridik. Sipas këtij kolegji, gjykata e apelit ka analizuar veprimet e kërkueses, duke çmuar provat në raport me faktin penal dhe akuzën e atribtuar asaj, vendimmarrja e saj është e arsyetuar dhe janë analizuar në tërësi veprimet e kërkueses, duke konkluduar për fajësinë e saj në përputhje me standardin përtej dyshimit të arsyeshëm. Kolegji Penal ka vlerësuar të drejtë edhe vendimmarrjen e gjykatës së apelit për sa i përket caktimit të llojit dhe masës së dënimit. Në përfundim, sipas këtij kolegji, gjykata e apelit ka arsyetuar në mënyrë shteruese elementet e veprës penale në raport me veprimet dhe mosveprimet e kryera nga kërkuesja, bazuar në rrethanat dhe në provat e verifikuara në këtë gjykim dhe me të drejtë i ka gjetur të bazuara pretendimet e paraqitura në ankim nga prokuroria, duke bërë një çmuarje të drejtë të provave referuar nenit 152 e vijuese të KPP-së. Pra, sipas Kolegjit Penal, në verifikimin e shkaqeve të rekursit nuk konstatohet mosrespektim ose zbatim i gabuar i ligjit material ose procedural, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, nuk evidentohet mosrespektim ose zbatim i gabuar i ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, si dhe nuk rezulton që vendimi i ankimuar është në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

33. Nisur nga sa më lart, në kuadrin e rrethanave të çështjes konkrete, Gjykata vëren se gjykata e apelit, ndonëse e ngarkuar me ligj për të shqyrtuar çështjen në aspektin faktik, nuk është ndalur në shqyrtimin dhe analizimin e plotë të provave të paraqitura nga kërkuesja, të cilat, sipas saj, provonin ekzistencën e marrëdhënies së punës. Në këtë këndvështrim, Gjykata rithekson se vlerësimi i provave është atribut i gjykatave të zakonshme, ndërsa juridiksionit kushtetues i takon të verifikojë nëse, gjatë këtij vlerësimi, janë respektuar standardet kushtetuese, përfshirë parimin e prezumimit të pafajësisë.

34. Në këtë kuptim, Gjykata thekson se, si rregull, barra e provës për ekzistencën e elementeve të veprës penale rëndon mbi organin e prokurorisë. Në rastin konkret, gjykata e apelit nuk rezulton të ketë analizuar faktin nëse prokuroria ka provuar se kërkuesja, për përfitimin e pensionit, kishte përdorur dokumente me përmbajtje të pavërtetë, konkretisht librezën e punës dhe vërtetimin e Ndërmarrjes Likuidatori të NFP-së, Krastë. Pra, kjo gjykatë nuk ka arritur të argumentojë faktin se ky dokument i prejardhur vërteton përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se dokumentet e paraqitura prej kërkueses – si mjete të supozuara si të përdorura për kryerjen e veprës penale – kanë përmbajtje të pavërtetë.

35. Nisur nga kjo premisë, Gjykata evidenton se të tria dokumentet në fjalë, përfshirë edhe dokumentin e prejardhur (duke pranuar se ai përkon me regjistrin e vjetërsisë në punë në kooperativë), përbëjnë dokumente zyrtare me fuqi të plotë provuese deri në provimin e së kundërtës. Megjithatë, gjykata e apelit ka pranuar si provë vendimtare vërtetimin nr. 781 prot.,

datë 14.5.2015 të DRSSH-së, Dibër, si dhe mungesën e të dhënave në regjistrat e ndërmarrjes, pa arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme përse njërit dokument i është njohur fuqi e plotë provuese, ndërsa dy të tjerëve jo. Ajo ka lënë të nënkuptohet se librezat e punës dhe vërtetimi i ndërmarrjes janë, të paktën intelektualisht të falsifikuara, pa administruar prova të drejtpërdrejta për pavërtetësinë e tyre si dhe pa sqaruar se çfarë konsiderohet “intelektualisht të falsifikuara” në raport me këto dokumente dhe cilat kanë qenë veprimet e kryera nga kërkuesja për të realizuar këtë falsifikim. Po kështu, Gjykata konstaton se gjykata e apelit nuk ka analizuar nëse dokumentacioni arkivor i ndërmarrjes është i plotë dhe i besueshëm, sidomos në kushtet kur gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se ky dokumentacion rezulton i paplotë. Ekzistenca e një dyshimi për plotësinë ose mangësinë e arkivit nuk mund të interpretohet në disfavor të kërkueses, pasi një dyshim i tillë, në dritën e parimit *in dubio pro reo*, duhet të shkojë në favor të saj.

36. Nga mënyra e arsyetimit të gjykatës së apelit, Gjykata vlerëson se kërkueses i është ngarkuar, në mënyrë të nënkuptuar, barra për të provuar pavërtetësinë e dokumentit të prejardhur të lëshuar nga institucionet përkatëse ose për të vërtetuar më tej ekzistencën e marrëdhënies së punës. Një qasje e tillë përbën përmbyesje të barrës së provës, në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajësisë, pasi është detyrë e organit të prokurorisë të provojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm si pavërtetësinë e dokumenteve, ashtu edhe elementet e tjera të veprës penale.

37. Gjithashtu, Gjykata konstaton se kërkuesja këto pretendime i ka ngritur edhe në rekurs, duke argumentuar se gjykata e apelit ka analizuar vetëm provat që mbështesnin akuzën, duke lënë pa trajtuar në mënyrë të argumentuar provat në favor të saj dhe duke mos provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm elementet e veprës penale. Megjithatë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është mjaftuar me konstatimin e përgjithshëm se gjykata e apelit ka bërë një çmuarje të drejtë të provave dhe një interpretim të saktë të ligjit, duke e konsideruar çështjen si të lidhur me vlerësimin e provave dhe, për rrjedhojë, jashtë kontrollit të tij rishikues ekskluzivisht ligjor. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë ka mbajtur një qasje formaliste, pa analizuar nëse standardi kushtetues i provueshmërisë së fajësisë dhe rregullat mbi barrën e provës janë respektuar nga ana e gjykatës së apelit.

38. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se, duke mos mbajtur një qëndrim të shprehur dhe substancial për pretendimet me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs, në veçanti lidhur me parimin e prezumimit të pafajësisë, standardin përtej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe ndalimin e përmbyesjes së barrës së provës, Gjykata e Lartë nuk ka përmbyshur standardin e arsyetimit të vendimit. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkueses për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit është i bazuar.

39. Në përfundim, Gjykata çmon se, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, kërkesa është e bazuar, ndaj ajo pranohet pjesërisht.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-312, datë 27.2.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.  
Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**Marrë më 24.2.2026.**

**Shpallur më 19.3.2026.**

**Kryetare:** Fiona Papajorgji

**Anëtarë:** Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Sandër Beci, Asim Vokshi, Marjana Semini